

VENDIM
Nr. 497, datë 21.6.2013

PËR KALIMIN E SIPËRFAQES PREJ 300 M², TRUALL, PRONË SHTETËRORE, NË PRONËSI TË MYFTINISË TIRANË, PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE LIGJORE QË NEVOJITEN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË “SELITË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e sipërfaqes prej 300 (treqind) m², truall e përfshirë brenda pronës me nr. pasurie 3/127, vol. 2, faqe 173, e ndodhur në zonën kadastrale 8240, në pronësi të Myftinisë Tiranë, me qëllim ndjekjen e procedurave ligjore që nevojiten për ndërtimin e xhamisë “Selitë”, për Komunitetin Mysliman Shqiptar.
 2. Myftinisë Tiranë i ndalohet tjetërsimi apo dhënia në përdorim e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për qëllime të tjera, të ndryshme nga ndërtimi i xhamisë “Selitë”.
 3. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.
 4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha